REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org: 01
Org.Jedinica
Org Unit
Nr.Prot:
Broj Prot:
Prot.No: 05-2349
Nr.i faqeve: -17-
Broj strana
Pages
Data: 16 04 26
Datum
Date

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Njësia Org: 01
Org. Jedin.
Org Unit
Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No: 1659
Nr. i faqeve
Broj stranica
Pages: - 17 -
Data
Datum
Date: 16 04 2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravlja- Ministry of Health

Agjencioni i Kosovës për Produkte Medicinale (AKPM) / Kosovska Agencija za Medicinske Proizvode (KAMP) / Kosovo Medicines Agency (KMA)

Memo		
Data/Datum/Date:	16.04.2026	**Ref. No.:**
Nga/Od/From:	Arian Ahmeti- Ud. Drejtor Ekzekutiv i AKPPPM-së	
Për/Za/To:	Dr. Arben Vitia - Ministër i Shëndetësisë	
Cc/cc/cc:	Jahë Gecaj – Ud. Sekretar i Përgjithshëm MSH Sevdije Rushiti – Ud. Drejtor i DAFB-së në AKPPPM-së Muhamer Beshiri – Ud Drejtor i Departamentit të Farmakovigjilencës	
Lënda/Subjekat/Subject:	Raporti i Performancës së Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale 2025	

I nderuar,

Të bashkangjitur kësaj shkrese do të gjeni "Raportin e Performancës së Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale 2025"

Me respekt

Agjencia e Kosovës për produkte dhe Pajisje Medicinale
Kosova Medicines Agency
Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstava

Raporti i Performancës së Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale 2025

Prishtinë, Mars 2026

Përmbajtja

Lista e shkurtesave..... 3

Përmbledhje ekzekutive.....4

Hyrja dhe qëllimi i raportit..... 5

Vlerësimi i objektivave dhe përmbushja e qëllimeve..... 6

Kostoja Financiare 10

Përfundimi dhe rekomandimi për përmirësim.....11

Aneksi - Pjesa tabelare 12

Lista e shkurtesave

AKPPM-Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale
MSH-Ministria e Shëndetësisë
QRK-Qeveria e Republikës së Kosovës
ZKM-Zyra e Kryeministrit
SKQ-Sekretariati Koordinues i Qeverisë
DAM-Departamenti i Autorizim Marketingut
DABF-Departamenti i Administartes, Buxhetit dhe Financave
DL-Departamenti i Licencimit
PhV- Departamenti i Farmakovigjilences
KASH-Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
UA- Udhezimi Administrativ
OB-Organizata Buxhetore
QB-Qarkorja Buxhetore
OE-Operatori Ekonomik
ZKA-Zyrtari Kryesor Adminstrativ
ZKF-Zyrtari Kryesor Financiar
PVPQ-Plani Vjetor i Prioriteteve të Qeverisë
OMSH-Objektivat e Ministrisë së Shëndetësisë
GP-Grupi punues
PP-Plani i Performances
DAE-Drejtori i Agjencisë Ekzekutive
NJPMP-Njesia Përgjegjëse për Menaxhimin e Performances
RP-Raporti i Performances
DPVA-Deklarata e Performanes Vjetore të Agjencisë
PPPP-Pjesa Pershkruese e Planit të Performances
PTPP-Pjesa Tabelare e Planit të Performanes
RP- Rishikimi i Planit
DPP -Draft Plani i Performanes
KB- Konsultimi i Brendshëm
MP -Miratimi i planit
PP - Publikimi i planit

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti i performancës së Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (më tutje AKPPM) është një dokument që vlerëson dhe përmbledh rezultatet e punës së AKPPM-së gjatë periudhës një vjeçare e cila kërkohet sipas *Rregullores (QRK) NR. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore* https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=73509 .

Hartimi i këtij raporti bazohet në vlerësimin e shkallës së përmbushjes së objektivave të planit të performancës, në efikasitetin e realizimit të tyre, si dhe në identifikimin e mangësive dhe të opsioneve të mundshme për përmirësim në të ardhmen.

Gjatë hartimit të këtij Raporti është marrë parasysh përmbushja e standardeve të kërkuara sipas nenit 8 paragrafi 3 i Rregullores (QRK) NR.12/2023 si në vijim:

- informata për nivelin e përmbushjes së objektivave bazuar në rezultatet e arritura dhe ndikimet e pritshme të përcaktuara në Planin e Performancës;
- zbatimin e secilës detyrë të Planit të Performancës dhe informata nëse aktivitetet janë zbatuar brenda afatit të përcaktuar në plan apo nuk janë zbatuar;
- në rastet kur është konstatuar se nuk është arritur rezultati i paraparë, raporti duhet të përmbajë shënime shpjeguese për çdo rrethanë që ka ndikuar në mos arritjen e rezultatit të synuar;
- shpenzimin e buxhetit të planifikuar për secilin aktivitet të përcaktuar në Plan të Performancës;
- rekomandimet për përmirësimin e Planit të Performancës për vitin vijues dhe adresimin e problemeve të hasura gjatë zbatimit.

Hyrja dhe qëllimi i raportit

Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale dhe Pajisje Medicinale është autoritet kompetent i Republikës së Kosovës përkitazi me produktet dhe pajisjet medicinale për përdorim njerëzor.

AKPPM është organ i pavarur ekzekutiv i Ministrisë së Shëndetësisë me subjektivitet juridik, që ka përgjegjësi ligjore përkitazi me çështjet shkencore dhe teknike që kanë të bëjë me produktet dhe pajisjet medicinale për përdorim njerëzor.

Agjencia ka për qëllim që të përcaktojë rregullat dhe procedurat për prodhimin, kontrollin e cilësisë, klasifikimin, autorizimin për marketing, regjistrimin, importin, tregtimin, farmakovigjilencën, hulumtimet klinike, mbikëqyrjen e produkteve medicinale dhe pajisjeve medicinale në Republikën e Kosovës në mënyrë që qytetarët të kenë produkte medicinale të sigurta, efektive dhe kualitative.

Raporti i performancës së AKPPM-së bazën ligjore e ka në pajtim me nenin 30, paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18684 si dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.12/2023 Mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=73509 .

Qëllimi kryesor i këtij Raportit të performancës është vlerësimi i arritjes së objektivave dhe rezultateve të arritura të përcaktuara në planin e performancës dhe aktiviteteve që Agjencia i ka synuar t'i realizojë brenda një viti.

Vlerësimi i objektivave dhe përmbushja e qëllimeve

Objektivat, treguesit e performancës, aktivitetet, rezultatet dhe shënimi shpjegues

Objektivat:

Sipas planit të performancës për vitin 2025 kanë qenë 3 objektiva kryesore të AKPPM-së:

I. Digjitalizimi i shërbimeve të ofruara në AKPPM;
II. Ndërlidhja e sistemit barnatari me raporte bankare të gjeneruara nga sistemi i Thesarit;
III. Testimi vjetor i cilësisë së antibiotikëve (INN) nga të gjitha nëngrupet e antibiotikëve të përdorur në vend.

I. Objektiva e I-rë: Digjitalizimi i shërbimeve që ofrohen në AKPPM;

Përmes këtij objektivit është synuar vazhdimi i zhvillimit të moduleve të reja dhe implementimi i atyre që janë në proces, zhvillimi i Modulit të tiketave siguruese (banderolave) që do të thotë shtypja e tiketave siguruese (banderolave) për produkte medicinale me çmim, dhe implementimi i modulit të Variacioneve që bënë lehtësim të shërbimeve në kuadër të Departamentit të AM-së.

Treguesit e performancës:
Treguesit e performancës lidhur me progresin për arritjen e objektivës së parë janë:

- Numri i tiketave siguruese (banderolave) të shtypura me çmim;
- Numri i produkteve medicinale me çmime të nivelizuara;
- Numri i Variacioneve të aplikuara online/përmes sistemit/modulit të Variacioneve;

Aktivitetet:
Aktivitetet e ndërmarra për përmbushjen e objektivës së I-rë ishin:

- Zhvillimi dhe mirëmbajtja e moduleve te reja në sistemin "Barnatari";
  - Moduli i tiketave siguruese (banderolave) me çmim;
  - Moduli i deklarimit të çmimeve për produkte medicinale;

- Implementimi dhe mirëmabajtja e modulit të Variacioneve në sistemin "Barnatari";
  - Gjenerimi i fletëpagesës digjitale për aplikim në sistemin "Barnatari";
  - Gjenerimi i listës së Variacioneve të aprovuara në kohën reale;
  - Efikasiteti i evaluimit të variacioneve;
  - Digjitalizimi dhe arkivimi i dosjeve të aplikuara pë Variacione;
  - Përshpejtimi i evaluimit të dosjes/eve të aplikuara;

- Aprovimi elektronik i variacioneve.

Vlera faktike:

- Gjatë periudhës së mëhershme nuk janë shtypur banderola me çmim (numri i banderolave të shtypura me çmim është 0).
- Gjatë periudhës së mëhershme nuk ka pasur produkte medicinale me çmime të nivelizuara (numri 0)
- Gjatë vitit 2024 përmes aplikimit fizik afërsisht kanë aplikuar 1738 Variacione dhe janë Aprovuar/refuzuar 1661 Variacione, 438 lëndë kanë mbetur në shqyrtim nga vitet paraprake.

Rezultatet e planifikuara:

Rezultatet e synuara përmes kësaj objektive ishin krijimi i lehtësirave në ofrimin dhe pranimin e shërbimeve online përmes zhvillimit dhe funksionalizimit të Moduleve në sistemin Barnatari, nivelizimi i çmimit të barnave në nivel të vendit, efikasiteti dhe përshpejtimi i evaluimit të dosjes/eve të aplikuara dhe aprovimi elektronik i Variacioneve.

Rezultatet e përfunduara:

Zhvillimi dhe funksionalizimi i moduleve:

- Moduli i tiketave siguruese (banderolave) me çmim; Nga shkurti i vitit 2025 të gjitha banderolat janë shtypur me çmim. Gjatë vitit 2025 gjithsejtë janë shtypur afërsisht **38,843,422** banderola me çmim;
- Moduli i deklarimit të çmimeve për produkte medicinale; Gjatë vitit 2025 është zhvilluar dhe funksionalizuar Moduli i aplikimit për deklarim të çmimeve përmes sistemit "Barnatari" ku subjektet aplikojn përmes në mënyrë elektronike përmes sistemit Barnatari;
- Implementimi dhe mirëmbajtja e modulit të variacioneve; Gjatë vitit 2025, përmes Modulit të Variacioneve në sistemin Barnatari, janë aplikuar gjithsej **2,027** variacione, prej të cilave janë aprovuar/refuzuar **1,371,** duke përfshirë edhe **483** lëndë të bartura nga vitet 2023 dhe 2024.

Shënim shpjegues

Moduli i banderolave në sistemin Barnatari ka qenë funksional që nga viti 2018. Në janar 2025, ky modul është modifikuar për të mundësuar shtypjen e çmimit në banderolë (http://barnatarint.rks-gov.net/), në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-220 për Çmimin e Produkteve Medicinale https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=79015 .

Ndërkohë, Ligji Nr. 08/L-220 ka filluar të zbatohet pas zyrtarizimit të listës së çmimeve të produkteve medicinale me vendim të Ministrit (nr. protokolli 05-10072, datë 23.12.2024), ndërsa lista ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2025 https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Vendi52614516.6615.pdf .

Me hyrjen në fuqi të kësaj liste, njëkohësisht ka filluar edhe shtypja e banderolave me çmim, duke siguruar që produktet medicinale të plasohen në treg me çmime të harmonizuara sipas listës zyrtare. Në këtë mënyrë është realizuar nivelizimi i çmimeve për të gjitha produktet medicinale të pajisura me banderola, duke garantuar zbatim të njëtrajtshëm të çmimeve në treg.

Me implementimin e këtij moduli janë krijuar lehtësira të konsiderueshme në procesin e aplikimit, evaluimit dhe aprovimit të variacioneve. Si rezultat, është rritur numri i aplikimeve, është përshpejtuar evaluimi i dosjeve dhe është mundësuar aprovimi/refuzimi elektronik i variacioneve. Po ashtu, sistemi siguron ruajtjen dhe arkivimin elektronik të të gjitha dosjeve në kuadër të sistemit "Barnatari" http://barnatarint.rks-gov.net/ .

Digjitalizimi i modulit të variacioneve në vitin 2025 ka mundësuar jo vetëm rritjen e efikasitetit dhe transparencës së procesit, por edhe trajtimin e plotë të ngarkesës së krijuar nga vitet paraprake. Si rrjedhojë, të gjitha lëndët e pashqyrtuara nga vitet 2023 dhe 2024 janë integruar dhe trajtuar në kuadër të modulit të vitit 2025, duke vendosur një bazë të qëndrueshme për menaxhim më efikas dhe në kohë të aplikimeve në vijim.nga aplikimi, gjenerimi dhe shkarkimi i pagesës, realizimi i pagesës, deri te vendimmarrja për aprovimin apo anulimin e lëndës duke siguruar një proces më të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të lëndëve.

II. Objektiva e II-të: Ndërlidhja e sistemit barnatari me raporte bankare të gjeneruara nga sistemi i Thesarit;

Përmes këtij objektivit është synuar rritja e kontrollit financiar të të hyrave jotatimore të cilat grumbullohen duke u bazuar në ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Tarifat e shërbimeve të ofruara në AKPPM sipas planit legjislativ për vitin 2024.

Treguesit e performancës:
Treguesit e performancës lidhur me progresin për arritjen e objektivës së dytë janë:

- Numri i tarifave të mbledhura nga aplikimet për licencim dhe të barazuar me sistemin e Thesarit;
- Numri i tarifave të mbledhura nga aplikimet për banderola të barazuar me sistemin e Thesarit;
- Numri i tarifave të mbledhura nga regjistrimi i produkteve medicinale të barazuar me sistemin e Thesarit;
- Numri i tarifave të mbledhura nga importi i produkteve dhe pajisjeve medicinale të barazuar me sistemin e Thesarit;

Aktivitetet:
Aktivitetet e ndërmarra për përmbushjen e objektivës së II-rë ishin:

- Gjenerimi i unirefit me kod unik në sistemin "Barnatari";
- Aprovimi nga Thesari për ndryshim të kodit në fletëpagesat e gjeneruara nga sistemi "Barnatari"
- Gjenerimi i raporteve në baza mujore, tremujore dhe sipas nevojës;
- Barazimi i të hyrave në sistemin Barnatari me raporte bankare;
- Barazimi i të hyrave me MSH sipas raporteve të gjeneruara nga Thesari;
- Identifikimi në kohë reale me mospërputhshmërinë e fletëpagesave të gjeneruara nga sistemi Barnatarit me raporte bankare;

Vlera faktike:

Gjatë periudhës së mëhershme, gjenerimi i UNIREF-ave në sistemin "Barnatari" është bërë në të njëjtin format si UNIREF-i në formë fizike. Mirëpo, në bashkëpunim me Thesarin dhe operatorin ekonomik të kontraktuar për mirëmbajtjen e sistemit Barnatari, është arritur modifikimi i procesit të gjenerimit, duke kaluar në përdorimin e një kodi unik për secilin shërbim të aplikuar në sistemin Barnatari.

Rezultatet e planifikuara:

Rezultatet e synuara përmes kësaj objektive ishte rritja e kontrollit financiar të të hyrave jotatimore të cilat grumbullohen duke u bazuar në ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Tarifat e shërbimeve të ofruara në AKPPM 01/2015 https://akppm.rks-gov.net/DocumentsAndPublications/SinglePublication/8363 : Për arritjen e këtij objekti, është parashikuar dhe implementuar Moduli Treasury në sistemin Barnatari.

Rezultatet e përfunduara:
Gjatë vitit 2025, Moduli Treasury në sistemin Barnatari https://barnatarint.rks-gov.net/View/Finance/TreasuryList?Index=1 .ka mundësuar barazimin në kohë reale të të gjitha pagesave të aprovuara mes Barnatarit dhe institucioneve mikrofinanciare, duke përmirësuar ndjeshëm transparencën dhe efikasitetin e menaxhimit financiar.
Është bërë gjenerimi i unirefave me kod unik në sistemin "Barnatari" për: **2393** Banderola, **1728** unirefa për regjistrim te produkteve medicinale dhe **7681** unirefa për import te produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Shënim shpjegues

- Përmes modulit *Treasury* në sistemin e Barnatarit është bërë barazimi i të hyrave në formë të digjitalizuar ku siguria dhe efikasiteti i të hyrave është më i lartë dhe na mundësojnë në kohën reale raportimin e saktë duke i barazuar raportet bankare me sistem e Barnatarit.
- Krijimi i kodit unik në fletëpagesa/unirefa së bashku me Thesarin e ka mundësuar verifikimin e pagesave në mënyrë më të shpejtë dhe më të sigurtë.
- Konfirmimi i fletëpagesave në afat sa më të shkurtër në sistem dhe nxjerrja e raporteve në kohë reale janë dëshmi se Moduli Treasury në sistemin Barnatari ka kontribuar në rritjen e performancës së Agjencisë, duke siguruar gjithashtu kënaqësinë e palëve të interesit.

III. Objektiva e III: Testimi vjetor i cilesisë dhe sigurisë së antibiotikëve (INN) nga të gjitha nëngrupet e antibiotikëve të përdorur në vend

Përmes kësaj objektive është synuar vlerësimi i cilësisë dhe sigurisë së antibiotikëve që qarkullojnë në tregun e Republikës së Kosovës e cila është e paraparë përmes strategjisë sektoriale shëndetësore 2025-2030; Përmes rezultateve të analizave të antibiotikëve të testuar, dëshmohet cilësia e tyre dhe siguria për përdorim. Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve testuese në sektorin e shëndetësisë.

Treguesit e performancës:
Treguesit e performancës lidhur me progresin për arritjen e objektivës së III-të ishin:

- Numri i antibiotikëve të tesuar;

Aktivitetet:
Aktivitetet e parapara për përmbushjen e objektivës së III-të ishin:

- Testimi vjetor i cilësisë së antibiotikëve;

- Blerja e pajisjeve testuese për AKPPM;
- Marrja e mostrave
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe kapaciteteve testuese në sektorin e shëndetësisë;

Rezultatet e planifikuara:
Rezultatet e synuara përmes kësaj objektive ishte rritja e numrit të antibiotikëve që i nënshtrohen analizave të cilësisë si dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë për produkte medicinale e cila është e paraparë përmes strategjisë sektoriale shëndetësore 2025-2030 https://msh.rks-gov.net/Documents/DownloadDocument?fileName=Strat52325305.0266.pdf ; Kjo rritje është synuar të jetë për 20 % më e madhe.

Rezultatet e përfunduara:
Rezultatet e synuara përmes kësaj objektive nuk janë realizuar për arsye të punimeve që janë bërë në objektin e AKPPM-së; Megjithatë, kërkesat me rëndësi të veçantë janë dërguar dhe trajtuar në laboratoret referente në shtetet rajonale.

Shënim shpjegues
Përmbushja e këtij objektivi nuk është realizuar për arsye të punimeve që janë bërë në objektin e AKPPM-së; meqenëse Laboratori i Kontrollit të Cilësisë ka marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë të akredituar në shtetet referente, me qëllim kryerjen e analizave laboratorike në përputhje me kërkesat specifike dhe nevojat e paraqitura.
Me përfundimin e punimeve në objektin e AKPPM-së dhe me validimin dhe kalibrimin e pajisjeve laboratorike për kontrollin e cilësisë, do të arrihet edhe përmbushja e këtij objektivi sipas strategjisë sektoriale shëndetësore 2025-2030.

Kostoja financiare

I. Kostoja financiare për realizimin e këtij objektivi ishte parashikuar në alokimin prej 32,389.36 euro për zhvillimin e moduleve shtesë në sistemin Barnatari, si dhe një kontratë për mirëmbajtje në shumën prej 26,400 euro.

Megjithatë, zhvillimi i moduleve shtesë nuk ka përfunduar për shkak se Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në kontratë.

Blerja e serverit për ruajtjen e të dhënave, në shumën prej 20,000.00 euro, është realizuar dhe instaluar në fund të vitit 2025, duke mundësuar përmirësimin e kapaciteteve të ruajtjes dhe menaxhimit të të dhënave në sistemin Barnatari.

II. Objektiva e dytë "Ndërlidhja e sistemit barnatari me raporte bankare të gjeneruara nga sistemi i Thesarit"; Nuk ka pasur kosto financiare;

III. Objektiva e tretë "Testimi vjetor i cilësisë së antibiotikëve (INN) nga të gjitha nëngrupet e antibiotikëve të përdorur në vend" kostoja financiare për realizimin e këtij objektivi ka qenë e paraparë alokimi prej 150,000 euro. Ku janë paraparë blerja e pasijseve mjekësore; nuk janë realizuar për arsye të punimeve që janë bërë në objektin e AKPPM-së;

Përfundimi dhe rekomandimet

Raporti i performancës së Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) për vitin 2025 reflekton angazhimin dhe përpjekjet e agjencisë për të përmbushur objektivat e planifikuara, por gjithashtu identifikon sfida dhe aspekte ku mund të bëhen përmirësime.
Duke vlerësuar përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të realizuara, është e qartë se disa janë arritur plotësisht ose pjesërisht ose nuk janë realizuar në mënyrë të plotë për shkak të faktorëve të ndryshëm, përfshirë punimet në objektin e AKPPM-së.
Megjithatë, disa aktivitete të rëndësishme janë realizuar me sukses, si p.sh. iniciativat për digjitalizimin e shërbimeve dhe shtypja e tiketave siguruese (banderolave) me çmim që është proces i nivelizimit të çmimit të barnave në treg.

Në fund, përmirësimi i vazhdueshëm i strategjive dhe përpjekjeve të AKPPM-së është i nevojshëm për të siguruar që të arrihen objektivat e vitit 2026. Ndër rekomandimet kyçe janë përmirësimi i planifikimit dhe monitorimit të aktiviteteve, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë dhe agjencitë ndërkombëtare.
Agjencia ka mundësi të rrisë efikasitetin e saj përmes një monitorimi më të ngushtë dhe të përqendruar, që mund të çojë në rezultate më të mira në vitet në vazhdim.

Rekomandimet e përmbledhura dhe të zgjeruara mund të jenë si më poshtë:

1. **Përfundimi i zhvillimit dhe mirëmbajtjes së moduleve të Barnatarit dhe siguria e të dhënave:**
   Të ndërmerren masa për të siguruar që Operatori Ekonomik të përmbushë të gjitha kërkesat sipas kontratës, duke vendosur afate të qarta dhe duke monitoruar progresin në mënyrë të rregullt. Për më tepër, përdorimi i serverit të blerë në fund të vitit 2025 duhet të shoqërohet me procedura të qarta për backup, siguri dhe menaxhim efikas të të dhënave, duke shmangur humbjet ose keqmenaxhimin e informacionit.

2. **Shtimi i zyrtarëve dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore:**
   Për të përmirësuar efikasitetin, cilësinë dhe shpejtësinë e ofrimit të shërbimeve, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e performancës së Agjencisë, rekomandohet miratimi i një Rregulloreje për Sistematizimin e Organizimit të Brendshëm të AKPPM-së. Kjo rregullore do të sigurojë bazën ligjore për rekrutimin e zyrtarëve shtesë dhe do të mundësojë zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve, certifikimeve dhe programeve të zhvillimit të vazhdueshëm. Me shtimin e personelit të kualifikuar dhe zhvillimin e aftësive profesionale, do të rritet efikasiteti operacional, do të përmirësohet cilësia e shërbimeve dhe do të garantohet një menaxhim më i shpejtë dhe i standardizuar i procesve brenda Agjencisë.

3. **Digjitalizimi i plotë i të gjitha shërbimeve të AKPPM:**
   Për të përmirësuar aksesin dhe efikasitetin e shërbimeve, rekomandohet digjitalizimi i plotë i të gjitha shërbimeve të ofruara nga AKPPM. Ky proces përfshin modifikimin e web-faqes së AKPPM, duke mundësuar një qasje më të lehtë dhe të shpejtë për subjektet fizike dhe juridike. Digjitalizimi i shërbimeve rrit transparencën, zvogëlon kohën e pritjes për aplikime dhe kërkesa, përmirëson menaxhimin e të dhënave dhe siguron një proces më të standardizuar dhe efikas të ofrimit të shërbimeve. Ky hap është thelbësor për të rritur performancën institucionale dhe për të garantuar kënaqësinë e palëve të interesit.

Aneksi – Pjesa tabelare

Data:						
AGJENCIA	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale					
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Shëndetësisë					
Misioni i Agjencisë	Mbrojtja e Shëndetit publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes garantimit të cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të produkteve dhe paisjeve medicinale të plasuara në tregun e Republikë së Kosovës,					
Objektivat	Treguesi(t)	Vlera e synuar	Vlera faktike	Rezultatet (Autputet) e planifikuara	Rezultatet (Autputet) e përfunduara (Po/Jo)	Shënim shpjegues

1. **Digjitalizimi i shërbimeve që ofrohen në AKPPM**	1.Numri i tiketave siguruese (banderolave) të shtypura me çmim	90%	1. Gjatë periudhës së mëhershme nuk janë shtypura banderola me çmim (numri **0**)	1.Gjatë vitit 2025 gjithsej janë shtypur **38,843,422** banderola me çmim	1.Zhvillimi dhe mirëmbajtja e Modulit të tiketave siguruese (banderolave) me çmim;	Përmbushja e këtij objektivi është realizuar pothuajse plotësishtë ku është arritur vlera e synuar 90% .
	2.Numri i produkteve medicinale me banderola me çmime të nivelizuara;		2. Gjatë vitit periudhës së mëhershme nuk ka pasur produkte medicinale me çmime të nivelizuara (numri **0**)	2.Gjatë vitit 2025 është bërë nivelizimi i çmimit për gjithsej **4335** produkte medicinale të regjistruara	2. Nivelizimi çmimit për produkte medicinale të regjistruara	
	3.Numri i Variacioneve të aplikuara online/përmes sistemit/modulit të Variacioneve;		3. Gjatë vitit 2024 përmes aplikimit fizik afërsisht kanë aplikuar 1738 Variacione dhe janë Aprovuar/refuzuar 1661 Variacione, 438 lëndë kanë mbetur në shqyrtim	3. Implementimi dhe mirëmbajtja e modulit të variacioneve; Gjatë vitit 2025, përmes Modulit të Variacioneve në sistemin Barnatari, janë aplikuar gjithsej 2,027 variacione, prej të cilave janë aprovuar/refuzuar 1,371, duke	3. Implementimi dhe mirëmbajtja e modulit të variacioneve;	

			nga vitet paraprake.	përfshirë edhe 483 lëndë të bartura nga vitet 2023 dhe 2024		
2. **Ndërlidhja e sistemit barnatari me raporte bankare të gjeneruara nga sistemi i Thesarit**	1.Numri i tarifave të mbledhura nga aplikimet për licencim dhe të barazuar me sistemin e Thesarit; 2.Numri i tarifave të mbledhura nga aplikimet për banderola të barazuar me sistemin e Thesarit; 3.Numri i tarifave të mbledhura nga regjistrimi i produkteve medicinale të barazuar me sistemin e Thesarit; 4. Numri i	80% të shërbimeve ofrohen online	Gjatë periudhës së mëhershme, gjenerimi i UNIREF-ave në sistemin "Barnatari" është bërë në të njëjtin format si UNIREF-i në formë fizike.	Gjenerimi i unirefit me kod unik në sistemin "Barnatari"; Banderola: 2393 unirefa Regjistrim te produkteve: 1728 unirefa Import te	1. Moduli *Treasury* në sistemin Barnatari;	Përmbushja e këtij objektivi është realizuar plotësishtë ku është arritur dhe tejkaluar vlera e synuar 80%. Të gjithë uniref-at nga sistemi "Barnatari" gjenerohen me Kod të unifikuar ku përmes modulit Treasury në sistemin e Barnatarit bëhet barazimi i të hyrave në formë të digjitalizuar dhe siguria dhe efikasiteti i të hyrave është më i lartë dhe na mundësojnë në kohën reale raportimin e saktë duke i barazuar raportet bankare me sistem e Barnatarit.

	tarifave të mbledhuar nga importi i produkteve dhe pajisjeve medicinale të barazuar me sistemin e Thesarit;			produkteve dhe pajisjeve: 7684 unirefa		
3. **Testimi vjetor i cilesisë dhe sigurisë së antibiotikëve (INN) nga të gjitha nëngrupet e antibiotikëve të përdorur në vend**	Numri i antibiotikëve të tesuar;	-	20 % rritje e numrit të analizave	Rezultatet e synuara përmes kësaj objektive nuk janë realizuar për arsye të punimeve që janë bërë në objektin e AKPPM-së; Megjithatë, kërkesat me rëndësi të veçantë janë dërguar dhe trajtuar në laboratoret referente në shtetet rajonale.		Përmbushja e këtij objektivi nuk është realizuar për arsye të punimeve që janë bërë në objektin e AKPPM-së; meqenëse Laboratori i Kontrollit të Cilësisë ka marrëveshje bashkëpunimi me laboratorë të akredituar në shtetet referente, me qëllim kryerjen e analizave laboratorike në përputhje me kërkesat specifike dhe nevojat e paraqitura.

Arian Ahmeti

Drejtori i Agjencisë